

VENDIM
Nr.175, datë 25.5.1990

PËR FONDIN E VEÇANTË

Me propozimin e Ministrisë së Financave, të Komitetit të Shkencës e të Teknikës dhe të Këshilit të Përgjithshëm të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në ndërmarrje, institucione e organizata shoqërore krijohet fondi i veçantë për nxitjen kolektive ose individuale të punëtorëve e nëpunësve për shtimin e prodhimit dhe rritjen e efektivitetit ekonomik të tij, si dhe për nevojat social-kulturore të punonjësve.

2. Në ndërmarrjet e institucionet me drejtim ekonomik me llogari më vete fondi i veçantë llogaritet në masën 2 për qind të fondit të pagave të planifikuar.

Gjatë zbatimit, fondi i veçantë krijohet duke e korrigjuar shumën e llogaritur më sipër me përqindjen e plotësimit të së ardhurës neto të ndërmarrjes në shkallë vjeore.

Njësitë ekonomike me drejtim ekonomik të brendshëm me llogari më vete kanë të drejtë të krijojnë dhe të përdorin fondin e veçantë, pavarësisht nga plotësimi i detyrave nga ndërmarrja ose kombinati ku ato bëjnë pjesë.

3. Në ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, institucionet kërkimore-shkencore, bazat prodhuese të shkollave, batalionet fortifikuese, institucionet mjekësore, arsimore e kulturore, njësitë e reparteve ushtarake të paorganizuara me drejtim ekonomik me llogari më vete fondi i veçantë krijohet në masën 1,5 për qind mbi fondin e planifikuar të pagave.

4. Fondi i veçantë përdoret:

a) Për shpërblimin e punëtorëve e të nëpunësve të dalluar në plotësimin e detyrave. Masa e shpërblimit mund të jetë jo më shumë se një pagë mujore në vit.

b) Për shpenzime në dobi të kolektivit, për nevoja kulturore, veprimtari fizikulturore, organizim piknikësh e mbrëmjesh argëtimi (pa shpenzimet e ngrënies e të fjetës), për kampet ditore për fëmijët e punonjësve dhe për të përballuar shpenzimet për pagat për kohën që, sipas dispozitave të veçanta, aktivizohen në grupet artistike e amatore.

c) Për t'u siguruar punëtorëve e nëpunësve bileta falas për shtëpitë e pushimit, për dhënie ndihmash të menjëhershëm punonjësve në raste fatkeqësish (për vdekje ose sëmundja të rënda e të gjata të punonjësve ose të pjesëtarëve të familjes që kanë në ngarkim, si dhe për dëmtimet e pajisjeve të shtëpive të tyre nga tërmetet, përmbytjet e zjarret etj.). Ndihma të tilla mund t'u jepen edhe punonjësve që kanë punuar për një kohë të gjatë ose që vazhdojnë të aktivizohen edhe pas daljes në pension pa shpërblim. Për këto raste masa e shpërblimit mund të jetë deri në 1000 lekë.

5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.441, datë 19.12.1986 "Për përdorimin më drejt të stimujve materiale suplementare dhe të fondit të veçantë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.1991.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI